

# Plani mësimor kornizë

## Kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut (gjka)

### Hyrje

Që tridhjetë vite, me miratimin e Këshillit Arsimor, japin mësim mësuesit nga regjione të ndryshme gjuhësore dhe të rretheve kulturore të botës, kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut (GJKA). Ato kanë një vend të përhershëm në kuadër të shkollës fillore cyrihase qysh me Rregulloren e Këshillit të Edukimit të vitit 1992. Me këtë rregullore janë përcaktuar qartë kushtet e përgjithshme më të rëndësishme.

Mësuesit e gjka punësohen ose nga vendi i tyre i origjinës, ose nga ndonjë bartës grupi privat i hapësirës gjuhësore përkatëse, në mënyrë që t'i mësojnë nxënësit tanë të familjeve të emigruara në *gjuhën e parë* të tyre.

Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, nga Sektori i Pedagogjisë Interkulturore, bëhet përkrahja administrative dhe profesionale në organizimin dhe zhvillimin e kurseve të gjka. Që një kohë të gjatë në kuadër të drejtorisë qëndron "Grupi koordinues për kurset e gjka" dhe "Komisioni pedagogjik i gjka", në përbërje të të cilave janë përfaqësues të bartësve shtetërorë dhe privatë të kurseve si dhe të shkollës fillore cyrihase. Në këto komisione bisedohet mbi çështje konceptuale, pedagogjike dhe organizative.

Në vitet e fundit është pikasur gjithnjë e më tepër rëndësia e mësimit në gjuhën dhe kulturën e atdheut për integrimin dhe suksesin në mësim të fëmijëve me gjuhë të huaj dhe atyre shumëgjuhësorë në shkolla. Për të siguruar dhe përmirësuar kualitetin e kurseve të gjka, është me rëndësi që planet e ndryshme mësimore të njësohen dhe të harmonizohen me planin mësimor cyrihas. Ky shqyrtim na shtyri që të përpilohet Plani mësimor kornizë, si plotësim pedagogjik, për kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut (gjka), duke pasur parasysh kushtet paraprake strukturore të cilat janë të pranishme që disa vite.

Anëtarët e "Komisionit pedagogjik të gjka" dhe të "Grupit koordinues për kurset e gjka" nën udhëheqjen dhe përgjegjësinë e përgjegjësve kantonal për gjka, Tamara De Vito, e përpiluan Planin mësimor kornizë të gjka. Në këto dy komisione janë të përfaqësuar të gjithë ofruesit e kurseve të gjka në gjuhë të ndryshme, të njohur nga Këshilli Arsimor. Anëtarë të grupit punues ishin: Francesco Contu, Tamara De Vito, Béa Di Concilio, Annina Felix, Luisa Holzknacht, Carlo Matriciani, Zeynep Sanli dhe Radmila Simic. Persona të tjerë profesionistë e kanë mbështetur përpilimin e Planit mësimor kornizë, si: Renata Achermann, Marianne Sigg Frei, anëtarët e Komisionit pedagogjik të gjka, si dhe Markus Truniger dhe Gert Wülser Schoop, nga Sektor Pedagogjisë Interkulturore të Entit Shkollor Fillor. Institucionet zvicerane dhe ato të huaja e kanë miratuar Planin mësimor kornizë përmes një mbështetjeje të gjerë.

## Përpunimi i Planit mësimor kornizë u bë hap pas hapi:

- nga të gjithë pjesëmarrësit u kërkua që t'i shtrojnë mendimet e tyre,
- rreth përmbajtjeve dhe formulimeve u diskutua deri në gjërat më të imta, derisa u bë një skicë, e cila mund të dërgohej për miratim dhe
- qëndrimet nga miratimi u biseduan përsëri dhe u përfshinë në versionin përfundimtar.

Me këtë mënyrë të kujdesshme dhe të mundimshme të ecjes përpara, ishte e mundur të arrihet një ujdi e gjerë. Si bartësit e kurseve të gjka ashtu edhe institucionet shkollore dhe mësuesit e Shkollës fillore cyrihase e kanë miratuar këtë Plan mësimor kornizë të gjka. Ky është një parakusht i mirë, që ky plan të bëhet i njohur dhe të zbatohet efektshëm. Të gjithë pjesëmarrësve u takon një falënderim i thellë për punën e tyre të angazhuar dhe kompetente.

*Këshilltari qeveritar Prof. Dr. Ernst Buschor*

### 1. Qëllimi i planit mësimor kornizë të gjka

Ky plan mësimor ka për qëllim t'i njësojë qëllimet e vëna të kurseve të gjka. Ai propozon një kornizë, brenda së cilës ofruesit e ndryshëm të kurseve mund t'i sjellin qëllimet dhe përmbajtjet e tyre specifike. Plani mësimor mbështetet fort në strukturën, mendimet dhe nocionet e Planit mësimor të Shkollës Fillore të Cyrihut. Me këtë synohen këto gjëra:

- Kurset e gjka përjetojnë një përafrim përmbajtësor me Shkollën Fillore të Cyrihut.
- Integrimi i kurseve të gjka në fushën arsimore cyrihase përmirësohet.
- Ofruesit e kurseve me këtë mënyrë përkrahen në drejtim të sigurimit dhe përmirësimit të kualitetit të tyre arsimor.
- Kurset e gjka fitojnë më shumë rëndësi tek bartësit.
- Gjendja e informimit mbi kurset e gjka përmirësohet.
- Kurset e ndryshme të gjka marrin parasysh mendimet e Shkollës fillore për një ofertë mundësisht të njejtë arsimimi dhe të shansave të barabarta.
- Bashkëpunimi mes personelit mësimor të kurseve të gjka dhe të personelit mësimor cyrihas përmirësohet dhe thjeshtësohet.

Krejt kjo çon tek një rritje e vlerës së kurseve të gjka në fushën arsimore cyrihase. Nëse arrihet që kurset e gjka potencialet e pranishme gjuhësore dhe *kompetencat interkulturore* të nxënësve dhe nxënësve të tyre t'i shpalosin në mënyrë optimale, do të përfitojnë jo vetëm individët e veçantë, por në fund të fundit e tërë shoqëria.

Plani mësimor kornizë ka karakter këshillues, dhe kuptohet si një linjë udhëheqëse, si instrument drejtues:

Bartësve, të cilët ndërtojnë oferta të reja të kurseve, u shërben ky plan si bazë. Personeli arsimor i bartësve shtetërorë merr parasysh propozimet e përmajtjeve (shiko kapitullin 7) në raport me programet e ministrive të arsimit të *vendeve të tyre të origjinës*<sup>1</sup>. Këtu duhet të kihet parasysh se personeli mësimor- i cili ka dy lekcione në javë dhe pjesërisht edhe ka grupe heterogjene moshash dhe aftësishe - si në fushën e qëllimeve të larta orientuese të vëna, ashtu edhe në katalogun e temave nuk mund t'i vënë më shumë se sa si pika qendrore.

<sup>1</sup>Të gjitha nocionet e shkruara në mënyrë kurzive definoohen dhe sqarohen në fjalorth (kapitulli 8,) sepse ato janë me rëndësi qendrore për interpretimin e përmbajtjeve

Për ta lehtësuar kuptimin, janë futur kapituj, të cilët sa i përket përmbajtjes së një plani mësimor, shkojnë edhe më tutje: kapitulli 2 informon mbi zhvillimin e kurseve të gjka dhe kapitulli 4, kryerjeshti 1 mbi Rregulloren në Kantonin e Cyrihut. Në mënyrë analoge me Planin mësimor të Cyrihut, edhe për mësimin e gjka, së pari formulohen idetë kryesore (kapitulli 3). Më vonë përshkruhen kushtet (kapitulli 4), për të shkuar në fund në fushën konkrete të këtij plani mësimor me veçoritë (kapitulli 5) dhe qëllimet orientuese (kapitulli 6).

Qëllimet orientuese duhet të arrihen në përfundim të shkollimit të obliguar- në Kantonin e Cyrihut pas nëntë vitesh. Qëllimet e cikleve dhe qëllimet specifike për klasat- të ashtuquajturat qëllime në vija të trasha - në këtë dokument nuk qëndrojnë. Kjo detyrë do t'iu lihet parimisht bartësve të kurseve veç e veç, gjegjësisht personelit mësimor të gjka. Në kapitullin e 7 gjendet - si një ndihmë orientuese - një vështrim mbi temat e pjesshme -dhe temat kornizë. Në fjalorth (kapitulli 8) sqarohen nocionet qendrore, të cilat janë të rëndësishme për kuptimin e Planit mësimor, dhe të cilat kontribuojnë për ta kuptuar më mirë situatën specifike të fëmijëve nga familjet e emigruara. (Këto nocione në tekst janë të shënuara me shkrim kursiv.)

## 2. Zhvillimi i kurseve në gjuhën dhe kulturën e atdheut:

nga fillimet e deri më sot

Me iniciativën e refugjatëve politikë nga Italia, në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar, në Kantonin e Cyrihut, filluan kurset e para në gjuhën dhe kulturën e atdheut (gjka). Me rritjen e emigracionit italian numri i kurseve italiane të gjka u rrit gjithnjë e më tepër. Në vitet e mëvonshme gjashtëdhjetë dhe në fillimet e viteve shtatëdhjetë, filluan edhe shoqatat e prindërve të nacionaliteteve të tjera të ofrojnë kurse të tilla. Gjithnjë e më tepër organizimi i tyre u mor përsipër nga disa vende të origjinës. Drejtorja e Arsimit u lejonte hëpërhë vetëm emigrantëve italianë, që të zhvillojnë kurse të tilla në kuadër të shkollës fillore. Veç kësaj kurset nuk ishin të përfshira në sistemin shkollor cyrihas ( Vendimi i parë i Kantonit të Cyrihut për kurset e gjka u mor më 21 qershor 1966).

Në një vendim të mëvonshëm (16 maj 1972) Këshilli arsimor u la duar të lira komunave shkollore që t'i intergojnë në orarin e rregullt mësimor kurset italiane e gjithashtu edhe kurset e reja spanjolle të gjka. Në të njëjtin vit Konferenca Zvicerane e Drejtorëve Kantonalë të Edukimit EDK, këshilloi që të lejohen dy orë të mësimit plotësues në gjuhën dhe kulturën e atdheut, mbrenda orarit të rregullt mësimor.

Më 1982, konsulata italiane dhe spanjolle si dhe "Grupi Koordinativ i Shoqatave të Bashkuara të Prindërve Emigrantë në Kantonin e Cyrihut" kërkuan nga Këshilli i Edukimit që t'i integrojë kurset e gjka në entet shkollore si dhe të lejojë që nota e kurseve të gjka të bartet edhe në dëftesë. Me vendimin e tij të datës 8 nëntor 1983 Këshilli i Edukimit i mori parasysh këto dëshira dhe i lejoi kurset e gjka të të gjitha

nacionaliteteve në formë eksperimentuese. Ky rregullim i ri ua rriti vlerën kurseve dhe i bëri më të njohura. Njëkohësisht, ofruesit e kurseve gjka, institucionet cyrihase dhe personeli arsimor filluan të bashkëpunojnë në mënyrë më të kordinuar (zhvillimi i planeve mësimore dhe mjeteve mësimore specifike për gjka, arsimime të mëtejshme, pilotprojekte). Pas një faze tetëvjeçare eksperimentuese u vlerësuan përvojat e fituara dhe u filluan hapat për një vendim tjetër të këshillit të edukimit.

Rregullorja e sotme në fuqi për "Zhvillimin e Kurseve të gjuhës dhe kulturës së atdheut" (Vendim i Këshillit të Edukimit të 11 qershorit 1992) i ka ngulitur kurset brenda sistemit shkollor cyrihas. Kjo rregullore mundëson për herë të parë njohjen e kurseve të reja edhe nga bartësit joshtetërorë të kurseve.

Në vitet tetëdhjetë, pos Italisë, kurset e gjka i udhëheqnin ende vetëm pak vende emigruese. Tek në vitet nëntëdhjetë u paraqitën ofrues të tjerë të kurseve: Përpos gjashtë bartësve tradicionalë - Italisë, Spanjës, Jugosllavisë, Turqisë, Greqisë dhe Portugalisë - erdhën në mënyrë të vazhdueshme edhe bartës të tjerë.

Financimi i kurseve të gjka bëhet nga vetë bartësit e kurseve dhe gjithashtu edhe pjesërisht nga kontributet e prindërve.

Në vitin 2002/03, në Kantonin e Cyrihut, afër 185 mësues/-e të gjka u japin mësim plot 9500 nxënësve dhe nxënësve, në mbi 20 gjuhë.

Kurset e njohura të gjka që ofrohen nga konsullatat dhe ambasadat janë:

Greqisht	Portugezisht	Spanjisht
Italisht	Serbisht	Turqisht
Kroatisht	Sillovenisht	Hungarisht

Kurset e gjka nga bartësit e njohur, por jo-shtetërorë

Shqip	Koreanisht	Frëngjisht
Kinezisht	Portugezisht (braziliane)	
Finlandisht	Spanjollisht (Amerika Latine)	

Kurset e gjka nga bartës të tjerë

Arabisht	Boshnjakisht	Tamilisht
Arabisht (Maroku)	Maqedonisht	Tibetisht
Arabisht (Tunizi)	Persisht	
Aramaisht	Somalisht	

Në fillim të viteve të nëntëdhjeta numri i pjesëmarrësve të kurseve të bartësve të njohur kishte plot 7500 fëmijë. Pas vitit 1992, vit në të cilin u aprovua "Rregullorja për udhëheqjen e kurseve të gjuhës dhe kulturës së atdheut" mund të tregohet një rritje e mëtejshme e numrit të vijuesve të kurseve. Në vitet pasuese ky numër u rrit vazhdimisht. Prej vitit 1995 rri mjaft konstant aty rreth 9000 deri 9500.

Sa i përket numrit të pjesëmarrësve (përqindja e pjesëmarrësve bazuar në popullatën prej nga vijnë nxënësit e vendeve të ndryshme të origjinës) të bartësve të ndryshëm ka dallime për tu vërejtur. Derisa bartësit e kurseve në gjuhën greke dhe spanjolle gati të gjithë fëmijët e "tyre" i arrijnë, tek ofruesit portugez dhe italian janë dy të tretat dhe tek ofruesi turk një e treta. Numri i pjesëmarrësve të fëmijëve sillovenë qëndron tek 50% dhe tek fëmijët kroat 30%. Shumë më tutje, me një pjesëmarrje prej plot 10% janë kurset jugosllave dhe kurset e gjuhës shqipe për fëmijët shqiptarë.

Arsyet për këto dallime të mëdha janë të larmishme. Për tu marrë parasysh është edhe numri i atyre që e kanë marrë shtetësinë zvicerane, e të cilët do të mund të ndikojnë në mënyrë markante në kuotën statistikore. Por edhe madhësia e grupit gjuhësor, situata financiare-organizative, gjendja politike në *vendin e origjinës* etj., mund të jenë faktorë determinues. Mirëkuptimi arsimor i njëzet kombeve, gjegjësisht i regjioneve gjuhësore mbinacionale është gjallërues në kurset e gjka. Janë njëzet arsye të ndryshme për emigrim dhe/ose ikje, histori të ndryshme, pikëpamje të ndryshme mbi jetën në Zvicër, të ndikuara nga kultura dhe gjuha personale.

Forma organizative e këtyre kurseve është poashtu e larmishme si dhe numri i tyre. Pa dashur për ta ngushtuar këtë larmi, ekziston nevoja që shkollën fillore cyrihase dhe kurset e gjka t'i ofrojmë më afër njëra-tjetrës. Plani mësimor kornizë dëshiron të japë një kontribut në këtë drejtim.

Fillimisht ky mësim ishte në shërbim të një riintegrimi shkollor në rast të kthimit në *vendin e origjinës*. Në vazhden e kohës janë bashkangjitur edhe vënia e qëllimeve të reja, të cila shkojnë në drejtim të një zhvillimi dygjuhësor dhe të një *integrimi* më të mirë të fëmijëve në shoqërinë e këtushme. Shumica e kurseve të gjka janë të hapura edhe për fëmijët e nacionaliteteve të tjera, nëse gjuha e kursit i përgjigjet *gjuhës së parë* të tyre ose veç qëndron një lidhje me "*vendin e origjinës*".

Në këtë kuptim po ecin që disa vite zhvillime të reja, si modelet "HSK plus" në kopshtin parashkollor dhe në shkollën primare, në të cilat qyteti i Cyrihut merr pjesë financiarisht. Në këto modele mësimi i gjka është i integruar në orarin e obligueshëm dhe mësuesit e gjka bashkëpunojnë në kolektivin e shkollës, p.sh., në Teamteaching interkulturore dhe në bashkëpunimin me prindër.

### 3. Mësimi i gjka - kuptimi dhe idetë e tij kryesore

#### Rreth nocionit:

Në kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut (gjka) fëmijët dhe të rinjtë shumëgjuhësorë i zgjerojnë njohuritë e tyre në *gjuhën e tyre amtare*-ndoshta i marrin edhe bazat e para për këtë - dhe njohuritë për kulturën e origjinës ose të prindërve të tyre ose të njërit nga prindërit. Ata konfrontohen me situatën e tyre "mes botërave të ndryshme" dhe përmes kësaj aftësohen për tu integruar në shoqëri, qoftë kjo në Zvicër, në ndonjë vend tjetër mikpritës ose ndoshta në vendin e origjinës, në të cilin mund të kthehen. Nxënëset dhe nxënësit shumëgjuhësorë marrin në kurset e gjka përkrahje në zhvillimin e tyre tërësor, kognitiv - gjuhësor, kulturor, social dhe emocional.

#### Idetë udhëheqëse:

- Në kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut mbretëron një klimë bazë pozitive; kjo mund të shprehet në gëzimin për të mësuar, në përvojat mendore, në lëvizje dhe në lojë.
- Kurset e gjka i përkrahin nxënëset dhe nxënësit në *gjuhën e tyre të origjinës* duke u bazuar në moshën dhe nivelin e tyre. Ato e forcojnë vetëdijen se dygjuhësia e tyre është një potencial plotësues, të cilin mund ta shfrytëzojnë. Shumëgjuhësia, e kuptuar si e mirë shoqërore, vlerësohet pozitivisht.
- Shumëgjuhësia po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në shoqërinë e sotme multikulturore, ajo është një resurs social, kulturor dhe ekonomik. Të rinjtë shumëgjuhësorë kanë mundësi të zgjeruara, për tu integruar në fushën e profesioneve dhe për t'i përmirësuar perspektivat e tyre rreth zgjedhjes së profesionit.

- Fëmijët dhe të rinjtë mësojnë të sillen me rrënjët e ndryshme të identiteteve të tyre, të cilat vijnë si rezultat i përkatësive, kulturave, traditave dhe historive të ndryshme.
- Kurset i përkrahin nxënëset dhe nxënësit në zhvillimin e tyre personal. Ato kapin përvojat dhe njohuritë e fëmijëve si përsa i përket *kulturës së origjinës* ashtu edhe të *vendit mikpritës*, i thellojnë këto dhe i reflektojnë. Në këto përvoja dhe njohuri bëjnë pjesë pikëpamjet për vlerat dhe normat, zakonet, historia dhe religjioni. Dhënia e mësimëve konfesionale religjioze dhe e ideologjive politike (partiake) nuk janë pjesë përbërëse e kurseve.
- Kurset i përkrahin nxënëset dhe nxënësit në atësinë e tyre për t'i zgjidhur konfliktet, në kompetencat e tyre interkulturore dhe në aftësinë e tyre për të gjykuar. Ato përkrahin një qëndrim të hapur, tolerant dhe antiracist.
- Kurset i përkrahin nxënëset dhe nxënësit që të integrohen në *vendin mikpritës*. Ato kanë funksion të një ure lidhëse: Në anën shkollore ato përkrahin ndërveprimin e sistemeve shkolle dhe familje si dhe integrimin e nxënësve me origjinë të huaj në shkollën fillore. Në anën shoqërore ato përkrahin *proceset integruese* mes shumicës dhe të të migruarve.
- Kurset i përkrahin nxënëset dhe nxënësit që të gjenden sa më mirë për një (ri-)hyrje shkollore, në rast të një kthimi eventual në *vendin e origjinës*.
- Mësimi në kurset e gjka orientohet në dhjetë parimet, të cilat i ka formuluar plani mësimor i Kantonit të Cyrihut si ideale për shkollën fillore: Interesi për dituri të reja dhe aftësi orientuese, ndjenja e përgjegjësise, gatishmëria për të treguar sukses, aftësia dialoguese dhe solidariteti, vetëdija për traditën, vetëdija për ambientin, aftësia gjykuese- dhe kritikuese, çiltërsia, prehja.

#### 4. Kushtet e përgjithshme

##### 4.1 Rregullorja mbi udhëheqjen e kurseve në gjuhën dhe kulturën e atdheut (gjka)

**Më 11 qershor 1992 Këshilli i Edukimit për Kantonin e Cyrihut ka miratuar këtë rregullore të mëposhtme.**

#### **Kuptimi**

§ 1. Në kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut (gjka), fëmijët dhe të rinjtë me *gjuhë të huaj* zgjerojnë njohuritë e tyre në *gjuhën e tyre amtare* dhe në *kulturën e origjinës*.

Vijimi i kurseve të gjka këshillohet, por është megjithatë me vetëdëshirë.

#### **Bartësi**

§ 2. Bartës të kurseve të gjka janë konsullatat ose ambasadat e vendeve të origjinës së fëmijëve me *gjuhë të huaj*.

Bartës të tjerë mund të njihen në bazë të kërkesës që i bëjnë Drejtorisë së Edukimit.

#### **Vlefshmëria**

§3. Kurset e gjka janë të lejuara në të gjitha klasët e shkollës fillore- duke përjashtuar klasën e parë.

Nxënëset dhe nxënësit e shkollave të mesme, që janë ende në moshën shkollore, mund t'i vijojnë gjithashtu këto kurse.

Për kopshtin parashkollor kompetencat qëndrojnë tek komunat. Komunave u këshillohet që të lejojnë grupet e kopshtit parashkollor të gjka. Kurset e gjka në kopshtin parashkollor nuk mund të përfshijnë mësimin e shkrim- leximit fillestar.

## Lajmërimi

§4. Prindërit i lajmërojnë fëmijët përmes mësuesit ose mësueses së klasës të shkollës fillore, në klasën e parë të shkollës primare. Këta pastaj i përcjellin më tutje përmes këshillit të shkollës tek bartësit e kurseve. Lajmërimi në kopshtin parashkollor është çështje e bartësve të kursit dhe e komunave shkollore.

Nxënëset dhe nxënësit *e posaçërisht* mund të lajmërohen përmes prindërve të tyre edhe drejtpërdrejt tek bartësit e kurseve.

Bartësit e kurseve i informojnë prindërit drejtpërdrejt mbi kohën e kurseve, vendin e kurseve dhe mësuesit (i informojnë edhe në rast se një kurs nuk mund të fillojë). Kurset e gjka fillojnë me fillimin e vitit të ri shkollor.

Lajmërimi i obligon nxënësit për një vijim të rregullt dhe vlen deri në çajmërimin që bëhet nga ana e prindërve. Parimisht kjo është e mundur vetëm në fund të vitit shkollor.

## Kohëzgjatja e kursit dhe koha

§5. Kurset e gjka përfshijnë më së shumti katër lekcione në javë.

Për kopshtin parashkollor lejohen maksimalisht dy lekcione në javë. Komunat shkollore janë të obliguara, në bazë të kërkesës së bartësve të kursit që t'i integrojnë dy lekcione në javë në orarin e rregullt mësimor<sup>2</sup>. Pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit e kursit për ta vijuar kursin e gjka, nëse kjo është e nevojshme, lirohen nga mësimi i rregullt që zhvillohet në të njëjtën kohë, për më së shumti dy lekcione në javë.

Bartësit e kursit i njoftojnë këshillat shkollore për kohën e dëshiruar të kurseve për vitin tjetër shkollor, më së largu deri më 31 mars. Koha definitive e kurseve përcaktohet pas marrëveshjes mes bartësve të kurseve dhe këshillave shkollore.

Bartësit e kurseve i informojnë këshillat shkollore dhe Drejtorinë e Edukimit (Sektorin e Pedagogjisë, Pedagogjia për të huajt) në fillim të vitit shkollor mbi organizimin definitiv të kurseve (klasat, koha, lokalet, mësuesit).

## Lokalet shkollore

§6. Komunat shkollore vënë në dispozicion, sipas mundësive, lokale të përshtatshme shkollore për kurset e gjka. Mësuesit e gjka janë të obliguar që të kujdesen për mbajtjen e rregullit shtëpiak.

Bartësit e kurseve i lajmërojnë çdo vit këshillat shkollore dhe atë më së largu deri më 31 mars, për kohën e dëshiruar të kurseve dhe numrin e nevojshëm të lokaleve shkollore.

## Mjetet mësimore / Materialet mësimore

§7. Komunitat shkollore vënë në dispozicion pa pagesë, sipas instruksionit paraprak të mësuesve të gjka, dhe në bazë të modaliteteve interne shkollore- dhe komunale, mjetet teknike mësimore (aparatin kopjues, projektorin e të tjera) si dhe materialin mësimor (shkumësa, fletore, letra e të ngjashme).

## Bartja e notës në dëftesë

§8. Fëmijët me *gjuhë të huaj*, të cilët i vijnë kurset e gjka, marrin një notë për suksesin e treguar në këto kurse. Nota e dhënë nga mësuesit e kurseve të gjka bartet nga mësuesit e klasëve në dëftesën e shkollës fillore.<sup>3</sup>

## Format e mëtutjeshme të integritit

§9. Këshilli i Edukimit mund të lejojë për eksperimentim, në bazë të një kërkesë përkatëse, forma të mëtutjeshme të integritit të kurseve të gjka.

## Bashkëpunimi pedagogjik

§10. Mësuesit e kurseve të gjka dhe mësuesit e shkollës fillore si dhe edukatorët e kopshtit parashkollor punojnë bashkërisht në edukimin e fëmijëve me *gjuhë të huaj*. Mësuesit e gjka mund të ftohen në konferenca ose në konventa të mësuesve.

Mësuesve të shkollës fillore iu këshillohet, që të marrin parasysh vlerësimin e mësuesve të gjka për vlerësimin e përgjithshëm të fëmijëve me *gjuhë të huaj* tek vendimet mbi kalime dhe promovime.<sup>4</sup>

## Koordinimi

§11. Nga ana e Drejtorisë së Edukimit përgjegjës në fushën e detyrave koordinuese për kurset e gjka është Sektori i Pedagogjisë për të huajt nga Dega e Pedagogjisë.<sup>5</sup>

Për shkëmbim informacionesh, për biseda rreth çështjeve organizative dhe konceptuale si dhe për trajtimin e çështjeve pedagogjike, metodike dhe didaktike përkujdesen „Grupi koordinues për kurset e gjka“ dhe Komisioni pedagogjik gjka“. Në të dy komisionet, përpos përfaqësuesve të shkollës fillore, ka vendin e vet edhe së paku nga një përfaqësues i bartësve të ndryshëm të kurseve.

Posaqërisht do të duhej që planet mësimore dhe materialet mësimore të kurseve të gjka të përputhen me planet mësimore cyrihase dhe të jenë të drejtuara nga nevojat e veçanta mësimore të fëmijëve me *gjuhë të huaj* që jetojnë këtu. Pestalozianum udhëheq kurse të arsimimit të mëtutjeshëm për mësuesit e kurseve të gjka, posaqërisht kurse hyrëse dhe kurse të mëtutjeshme të gjuhës gjermane.

Këshillave shkollore u këshillohet që në rast nevojë të caktojnë përgjegjës të nivelit komunal për detyra koordinuese. Këtij personi kontaktues i vëhet për detyrë që të bëjë marrëveshje me kohë për mënyrën e rregullimit të orarit mësimor dhe të nevojave për lokale shkollore.

## Mësuesit e gjka

§12. Zgjedhja dhe punësimi i mësuesve janë përgjegjësi e bartësve të kurseve.

Bartësit e kurseve janë të obliguar që të kujdesen që

- mësuesit e tyre, me rastin e fillimit të punës, të kenë njohuri të mjaftueshme nga gjuha gjermane për komunikim gojor dhe me shkrim.
- mësuesit e rinj të prezentohen tek Drejtoria e Edukimit (Dega e Pedagogjisë, Pedagogjia për të huajt) më së voni tre muaj pasi që kanë filluar punën në Kantonin e Cyrihut.
- mësuesit e rinj të vijojnë kursin hyrës që organizohet nga Pestalozzianum
- mësuesit me njohuri të pamjaftueshme nga gjuha gjermane të vijojnë kurse të mëtejshme
- përgjegjësit për detyrat koordinuese të jenë caktuar dhe në rast nevojë tu japin ditë të lira mësuesve që marrin përsipër detyra koordinuese.

Nëse një mësues nuk i plotëson kushtet, Drejtoria e Edukimit kërkon nga bartësi i kursit që të merren masat e nevojshme ose të zëvendësohet mësuesi dhe nëse është e domosdoshme mund t'i merret leja për të dhënë mësimin e gjka në kuadër të shkollës fillore.

Bartësve të kurseve u këshillohet që kohëzgjatjen e punës për mësuesit ta zgjasin për dhjetë vite dhe në raste të veçanta të heqin dorë nga një rotacion.

## Financimi

§ 13. Financimi i kurseve të gjka është çështje e bartësve të kurseve.

## Mbrojtja e siguruar

§ 14. Mbrojtja e siguruar e nxënësve dhe e nxënësve gjatë kohës së vijimit të kurseve të gjka dhe gjatë rrugës për në shkollë rregullohet nga komunat në mënyrë të njejtë sikur për shkollën fillore.

## Mbikëqyrja

§ 15. Kurset e gjka iu nënshtrohen bartësve të kurseve sa i përket aspektit përmbajtësor, didaktik dhe metodik, dhe për sa i përket disa pikave të rregulluara sipas kësaj rregulloreje, edhe mbikqyrjes së këshillave shkollorë komunale- e të rretheve. Këto janë të lira në mënyrën e rregullimit të mbikqyrjes.

Kontrrolli i mungesave në kurse dhe marrja e masave të nevojshme për ata/ato që mungojnë rregullohen nga ana e bartësve të kurseve. Këshillave shkollorë dhe mësuesve, nëse kërkojnë një vështrim mbi kontrollin e mungesave, duhet t'iu mundësohet një gjë e tillë.

Në rast të shfaqjes së një gjendjeje të keqe vjen deri te një bisedë mes këshillave shkollorë përkatëse dhe bartësve të kurseve. Në rast të një gjendjeje shumë të keqe, e cila nuk menjanohet edhe pas paralajmërimit, Drejtoria e Edukimit mund t'ia marrë të drejtën bartësve përkatës të kurseve, pas kërkesës së një këshilli komunal ose të rrethit, që kurset e reklamuar të mos mund të udhëheqen në kuadër të shkollës fillore.

## 4.2 Parimet didaktike

### 4.2.1 Arsimimi elementar

Kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut zgjedhin përmbajtje të rëndësishme, ekzemplare. Duhet të zgjohet interesimi i fëmijëve për të paraqitur pyetje të veta dhe për të përpunuar përgjigje të përshtatshme dhe që ata të kenë gëzim për gjëra të reja. Gjërat njëherë të mësuara vijnë përsëri në

marrëdhënie të tjera, të ndërsjella.

Mësimi nisët nga përvojat dhe interesimet e fëmijëve dhe zgjon interesime të reja. Një lidhje e drejtëpërdrejtë me përmbajtjet mësimore është e dëshirueshme. Të nxënët do të duhej të jetë i lidhur me veprime personale bisedimore. Hapat në të nxënë si dhe detyrat duhet t'i përgjigjen mundësisht nivelit të secilit nxënës veç e veç.

Në mësim e kanë vendin e tyre elementet e lojës dhe puna në të shprehurit me gojë, posaqërisht tek nxënëset dhe nxënësit e rinj. Mësimi do të duhej që t'i aftësojë nxënësit, që të mësuarit e tyre ta bëjnë hap pas hapi, në mënyrë të pavarur.

#### **4.2.2 Vlerësimi i nxënësve dhe nxënësve**

Vlerësimi e përkrahë fëmijën gjatë të nxënët. Ai është rezultat i një vëzhgimi tërësor (vlerësimi i përgjithshëm) i cili merr parasysh si shkathtësitë që mund të maten ashtu edhe sjelljen në punë -, gjatë të të nxënët si dhe sjelljen sociale. Vlerësimi i forcon nxënësit në vetëbesimin e tyre dhe i aftëson ata, deri në një masë të mjaftueshme për ta vlerësuar vetveten.

Kriteret e vlerësimit në kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut i përgjigjen atyre kriterëve të shkollës fillore të Cyrihut. Notën e nxënësit në kursin e gjuhës dhe kulturës së atdheut e vë mësuesi-ja i/e gjuhës dhe kulturës së atdheut në një atest; mësuesi/-ja i/e klasës e bartë në dëftesën e shkollës fillore cyrihase.

Mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut e përkrahin mësuesin e klasës gjatë vlerësimit të nxënësve (posaqërisht gjatë promovimit dhe kalimit në ciklin e lartë të shkollës fillore).

#### **4.2.3 Detyrat e shtëpisë**

Detyrat e shtëpisë e përkrahin mësimin në mënyrë kuptimplotë. Ato janë një mundësi për tu konfrontuar me gjërat e mësuara jashtë procesit mësimor. Fëmijët do të duhej që detyrat e shtëpisë të kenë mundësi për t'i zgjidhur pa ndihmën e drejtëpërdrejtë të prindërve. Megjithatë është e pritur që prindërit të interesohen për të mësuarit e fëmijëve të tyre në kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut. Mësuesit marrin parasysh gjatë dhënies së detyrave mundësitë dhe suksesin e nxënësve ashtu që të mënjanojnë mbingarkimin e tyre.

#### **4.2.4 Mjetet mësimore dhe mjetet tjera ndihmëse në mësim**

Mjetet mësimore dhe mjetet e tjera ndihmëse për mësim përgatiten dhe vëhen në dispozicion nga bartësit e kurseve. Veçanërisht duhet patur parasysh që t'i u përgjigjen situatave speciale në të cilat gjenden vijuesit e kursit (dygjuhësia, përvoja e migrimit). Ato ndihmojnë për të plotësuar kërkesat e planit mësimor kornizë, përmes asaj që orientohen në bazë të tij dhe mundësojnë zbatimin e tij.

#### **4.2.5 Zgjedhja e metodës**

Gjatë zhvillimit të mësimit, mësuesit janë të lirë në zgjedhjen e metodës në kuadër të parimeve didaktike dhe të këtij plani. Ata zgjedhin metodën e cila në situata të caktuara mësimore i përgjigjet më së miri qëllimeve dhe përmbajtjeve si dhe nxënësve dhe mësuesve vetë. Ata marrin parasysh që të zbatojnë një mori metodash si instruksione direkte, të mësuarit individual, të mësuarit në grupe, të mësuarit kompleks përmes projekteve.

Zgjedhja e metodës i përgjigjet rrethanave, ku përbërja e klasës është shpesh heterogjene. Nxënësit vijnë nga klasë të ndryshme ose nga shkolla të ndryshme, i përkasin niveleve të moshave të ndryshme, kanë një të kaluar biografike të ndryshme dhe një gjendje gjuhësore të ndryshme.

### **4.3. Bashkëpunimi**

#### **4.3.1 Bashkëpunimi shkollë - prindër**

Bashkëpunimi mes shkollës dhe shtëpisë prindërore ka parimisht një ndikim të madh në të mësuarit si dhe në suksesin e fëmijëve dhe të rinjve. Në suksesin shkollor ndikon pozitivisht kur mësuesit kanë kontakt të rregullt me prindërit, i informojnë mbi ato që ndodhin në shkollë, flasin me ta se si t'i përkrahin fëmijët e tyre në të mësuar.

Mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut mund t'i përkrahin mësuesit e klasëve të rregullta si dhe mësuesit e gjuhës gjermane (në gjermanisht për të huajt si dhe në klasën e veçantë E) gjatë bashkëpunimit me prindër. Në këto raste ata mund të ndikojnë si mediator-e kulturor-e,- punë kjo që natyrisht kërkon njohuri të mira gjuhësore dhe njohje të sistemit shkollor. Mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut dhe mësuesit e klasëve të rregullta mund të organizojnë dhe mbajnë bashkërisht mbledhje me prindër.

Në marrëveshje me mësuesit dhe me entet shkollore ata kontribuojnë - në kuadër të kohës së mundur, të detyrave të profesionit që kanë ose edhe në bazë të marrëveshjes për pagesë - me përkthime dhe këshillime.

#### **4.3.2 Bashkëpunimi mes mësuesve të gjuhës dhe kulturës së atdheut dhe mësuesve të klasëve të rregullta si dhe të atyre të gjuhës gjermane për të huajt dhe të klasës së veçantë E**

Nëse të gjithë mësuesit që i mësojnë nxënësit bashkëpunojnë mes vete, kjo ndikon parimisht në mënyre pozitive në të mësuarit e nxënësve dhe të nxënësve.

Kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut dhe mësuesit të cilët i udhëheqin ato janë pjesë e shkollës. Mësuesit e klasës së rregullt, të gjuhës gjermane për fëmijët me gjuhë të huaj, të klasës së veçantë E dhe mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut kërkojnë në mënyrë të dyanshme kontakte. Si pjesë e kolektivit të shkollës, mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut, mund të marrin pjesë në aktivitetet e shkollës. Ata janë të integruar në proceset e zhvillimeve shkollore.

Posaqërisht mund të marrin pjesë në vlerësimin e nxënësve, në ndërmjetësimet kulturore dhe tek përballimi i konflikteve me aspekte sociokulturore.

Mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut ftohen nga kolegët e tyre të shkollës fillore, në konferenca, nëse në rend të ditës janë vënë tema me interes të dyanshëm.

Janë për tu përshëndetur takimet vjetore mes mësuesve të klasës së rregullt dhe mësuesve të gjuhës gjermane për të huajt, mësuesve të klasëve të veçanta dhe të mësuesve të gjuhës dhe kulturës së atdheut. Qëllimi i takimeve të tilla është njohja e dyanshme, shkëmbimi i njohurive dhe përvojave si dhe bisedat për brengat dhe situatat e ndryshme. Organizimi i vëhet në barrë komunës përkatëse, gjegjësisht kuartit shkollor ose kolektivit të shkollës.

Shkollat me një numër të lartë të nxënësve dygjuhësorë kanë një dobi të madhe nëse e institucionalizojnë bashkëpunimin me mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut. Kjo do të thotë për t'i përkrahur bashkërisht fëmijët veç e veç, për të realizuar projekte interkulturore ose edhe për t'i informuar dhe këshilluar bashkërisht prindërit.

Projekti mbi zhvillimin e shkollës QUIMS (Kualiteti në shkollat multikulturore) i Drejtorisë së Arsimit parasheh në modulën e tij për përkrahjen gjuhësore, që kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut të mos mbeten anash, por të jenë pjesë e programit shkollor të një QUIMS - shkolle.

#### **4.3.3 Bashkëpunimi me institucionet lokale dhe kantonale**

Institucionet lokale dhe kantonale marrin përsipër që kurset e gjuhës dhe kulturës së atdheut të mbahen nën kushte të mira në kuadër të shkollës fillore.

Institucionet përgjegjëse dhe mësuesit e gjuhës dhe kulturës së atdheut përkujdesen për kontakte dhe shkëmbime të dyanshme.

Institucionet lokale janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e kurseve të gjuhës dhe kulturës së atdheut, sipas Rregullores së Drejtorisë së Arsimit, në bazë të pikave të përcaktuara.

### **5. Veçoritë e mësimit të gjuhës dhe kulturës së atdheut**

#### **5.1 Për fushën mësimore «Gjuha e atdheut» (Fusha mësimore «Gjuha»)**

Gjendja gjuhësore e nxënësve dhe nxënësve në *gjuhën e origjinës* së tyre mund të jetë shumë e ndryshme. Mësimi ndërtohet mbi paranjohuritë e fëmijëve. Duke u nisur nga *gjuha familjare* gjegjësisht nga dialekti familjar ajo i afrohet hap pas hapi gjuhës letrare.

Për këtë arsye është e mundur që njohuritë gjuhësore të një fëmije në *gjuhën e tij të origjinës* ose të fëmijëve mbrenda një klase të përputhen me një gjuhë të parë ose një *gjuhë të dytë*. Për këtë arsye në mësimin e kurseve të gjka janë të domosdoshme parimet metodiko-didaktike për forcimin dhe zgjerimin e gjuhës së parë si dhe të atyre nga mësimi për gjuhë të huaja.

Fëmijët dhe të rinjtë e zgjerojnë të kuptuarit e tyre gjuhësor, duke bërë krahasimin mes gjuhës së gjka me gjuhën gjermane, në bazë të ciklit në të cilin janë. Ata i kuptojnë *interferencat* gjegjësisht krahasimet mes gjuhës së gjka dhe gjermanishtes.

Norma gjuhësore që përdoret në vendin e origjinës është përcaktuese për dhënien e rregullave gramatikore dhe ortografike. Nxënëset dhe nxënësit, megjithatë, nuk e mësojnë ortografinë dhe gramatikën si qëllim në vete.

Puna në leksik i aftëson ata që të mund të shprehën në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme dhe për fusha të ndryshme tematike.

Ata e përjetojnë, mundësisht shpesh dhe drejtpërdrejt, se si mund ta zbatojnë gjuhën e shkruar dhe të folur. Për këtë arsye personeli mësimor merr parasysh propozimet e nxënësve dhe të nxënësve si dhe ngjarjet aktuale. Veprimi kreativ me tekstet e zgjedhura letrare - si të vjetra ashtu edhe ato moderne - do të duhej që të përkrahë interesimin për *gjuhën letrare*.

Nxënëset dhe nxënësit fitojnë njohuri se si ndryshon dhe zhvillohet gjuha në *vendin e origjinës* së tyre.

Nëse gjuhët e kurseve të gjka nuk e përdorin alfabetin latin, duhet të merret parasysh fakti që shumica e nxënësve dhe të nxënësve veç janë alfabetizuar në gjermanisht dhe në alfabetin latin. Personeli mësimor ia përshat zhvillimin e shkrimit të dytë këtyre rrethanave (koha, metoda, kërkesa).

## 5.2 Për fushën mësimore "Kultura e Atdheut" (Fusha mësimore "Njeriu dhe ambienti")

Nxënëset dhe nxënësit konfrontohen me statusin e tyre specifik si fëmijë mërgimtarë dygjuhësorë. Ajo që ata i lidh në një klasë është gjuha e njëjtë e origjinës, vendi i njëjtë i origjinës si dhe përvoja të përafërta emigruese dhe përvoja e të qenit pakicë. Të ndryshme janë përvojat personale si dhe lidhjet me vendin e origjinës. Gjithashtu duhet të merren parasysh religjionet e ndryshme, statusi social, botëkuptimet dhe veçoritë gjeografike mbrenda vendit të njëjtë të origjinës.

Do të tematizohen konceptimet e vlerave nga *vendi i origjinës*. Pastaj kjo mund të vazhdojë me krahasimin e konceptimeve të vlerave të zviceraneve dhe të zviceranëve. Të qenurit i vetëdijshëm për gjërat e përbashkëta dhe dallimet, ndihmon në sqarimin e konceptimit të vlerave personale. Ky proces përkrah zhvillimin e një personaliteti të mëvetësishëm, që synon *integrimin* e sistemeve të ndryshme. Njëkohësisht kjo lidhje e forcon vetëdijën e nxënësve dhe të nxënësve.

Përvojat të cilat krijohen nga emigrimet - *përvojat emigruese* - dhe ato përvoja të cilat janë të lidhura me bashkëjetesën e dy kulturave në përditshmëri do të duhej të thirreshin në kujtesë.

Në mësimin e gjka do të trajtohen edhe tema sociale. Këtu zhvillohet një thellim i njohurive nga *kultura e origjinës*. Do të vështrohen mënyrat e jetesës, zakonet, festat dhe traditat e *vendit të origjinës* dhe kështu mund të bëhen edhe lidhje të tërthorta me Zvicrën. Ngjarjet konkrete duhet të jenë si shtysë për këtë.

Nxënëset dhe nxënësit e mësojnë historinë dhe gjeografinë e *vendit të origjinës* në pjesë ekzemplare. Duhet të merren parasysh lidhjet aktuale me jetën e sotme në *vendin e origjinës* dhe në *vendin mikpritës*.

Duhet të kihet parasysh një qëndrim tolerant, i hapur. Krahasimet pa paragjykime të regjioneve të ndryshme të origjinës, *dialekteve* ose gjuhëve dhe religjioneve mes tyre, si dhe krahasimet mes *vendit të origjinës* me Zvicrën ose edhe me vendet dhe kulturat e tjera, formojnë bazën për ndërtimin e kompetencës interkulturore. Ajo i shërben aftësisë për të bashkëjetuar gjithë respekt me kultura të ndryshme, për të bërë kompromise, si dhe për t'i zgjidhur konfliktet.

## 5.3 Udhëzime për mësimin në cikle të ndryshme

### Kopshti parashkollor<sup>6</sup>

Temat mësimore janë të lidhura me përjetimet e përditshme të fëmijëve në shtëpi, në kuart dhe në kopshtin parashkollor. Fëmijët e kësaj moshe mësojnë përmes veprimeve si lojë me materiale, dhe në situata të ndryshme ta kuptojnë atë që dëgjojnë dhe përmes kësaj të veprojnë në mënyrë përkatëse si dhe të flasin për to.

## Cikli i ulët

Pikënisje janë përvojat personale dhe të përditshme të së fëmijëve në familje, në *vendin e origjinës dhe në vendin mikpritës*. Lidhja e fëmijëve në këtë moshë me familjen dhe orientimi sipas konceptimit të vlerave të saj është ende e fortë.

Në qendër të mësimin janë të kuptuarit e asaj që dëgjojnë si dhe bisedat e ndryshme në formë loje. Hyrja në të lexuar dhe në të shkruar merr parasysh alfabetizimin në gjermanisht si gjuhë shkollore.

## Cikli i mesëm

Për fëmijët e ciklit të mesëm, grup-mosha e njëjtë është shumë e rëndësishme. Ky grup-moshë zhvillon një interesim natyror për mënyrat e ndryshme të jetës dhe të kulturave, me të cilat vjen në kontakt. Ai ka përgjithësisht një raport pozitiv me ambientin që e rrethon - familjen, shkollën, religjionin dhe gati fare nuk i vë këto gjëra në pyetje. Ky grup-moshë është parimisht objektiv, i hapur, spontan në raport me *kulturën e origjinës* dhe interesohet për marrëdhëniet dhe lidhjet me familjen e tij në vendin e origjinës.

Në mësim luan një rol të rëndësishëm të kuptuarit e të dëgjuarit në një nivel me kërkesa të larta, të lexuarit si dhe të shprehurit dhe të shkruarit.

## Cikli i lartë

Në ciklin e lartë të rinjtë konfrontohen gjithnjë e më tepër në mënyrë kritike me perceptimet e vlerave të tyre si dhe të vlerave të ambientit që i rrethon. Si pasojë, nën rrethana të caktuara ata shpeshohen prej normave dhe vlerave të origjinës, ose i idealizojnë ato. Shpesh të rinjtë rrëmbojnë me pyetje mbi kuptimin e kurseve të gjka.

Arsimtarja/-i e kupton këtë situatë transformimi, konfrontohet me të dhe sjell në mësim modele (-jetësore) kritike. Kjo i aftëson të rinjtë për tu orientuar, për ta zhvilluar personalitetin e tyre dhe për ta gjetur rrugën e vet.

Të rinjtë do të përkrahen veçanërisht, për t'i integruar në jetën e tyre përvojat e ndryshme, pikëpamjet për vlerat si dhe përkatësinë e tyre.

Mësimi merr parasysh aftësitë dhe njohuritë e tyre individuale dhe i përkrahë në këtë drejtim, që të zhvillojnë një personalitet të vetin dhe një perspektivë në fushën e profesionit. Një vlerë të rëndësishme në këtë drejtim luan komunikimi gojor dhe ai me shkrim, vështrimet gjuhësore dhe edukimi mbi mediat. Të rinjtë kanë rastin që t'i shfrytëzojnë njohuritë e fituara në gjuhë të ndryshme (në gjuhë të parë, gjermanisht, frëngjisht, anglisht), të tërheqin vija analoge dhe t'i ndërlidhin njohuritë e tyre. Kështu, ata mund t'i zgjerojnë kompetencat gjuhësore - dhe komunikuese.

## 6. Qëllimet orientuese të mësimin të gjka

Mësimi i gjka vë paraprakisht qëllime orientuese nga të dy fushat mësimore, në "Gjuhë" gjegjësisht në "Njeriu dhe mjedisi", të cilat qëllime i përcakton plani mësimor i shkollës fillore për klasën e rregullta. Qëllimet orientuese të mëposhtme kanë një rëndësi të veçantë për mësimin e gjka. Ato janë marrë pjesërisht nga plani mësimor cyrihas, pjesërisht janë ndryshuar lehtë ose edhe janë definuar në mënyrë plotësuese. Qëllimet orientuese do të duhej që të arrihen në përfundim të kohës së obliguar shkollore. Një nënndarje në qëllime të ciklit të ulët, të mesëm dhe të lartë mungon në këtë plan mësimor kornizë, sepse kjo ndodh tek te fusha e qëllimeve në vija të trasha.

Iu është lënë bartësve të kurseve veç e veç që t'i definojnë qëllimet në vija të trasha për specifikat e cikleve si dhe përmbajtjet përkatëse, në mënyrë që personeli mësimor të ketë mundësi të përgatitë konkretisht mësimin.

## 6.1 Gjuha

### Të dëgjuarit dhe të kuptuarit

Nxënëset dhe nxënësit mund të kuptojnë se çfarë po flitet në *gjuhën e tyre amtare*. Ata janë në gjendje që t'i ndjekin nga ana përmbajtësore diskutimet, referatat, programet e radios dhe të televizionit dhe mësojnë që të kenë një qëndrim kritik ndaj asaj që kanë dëgjuar.

Ata do të mësojnë gjithashtu të interpretojnë, se çka shprehet përmes akcentit dhe gjuhës së gjesteve.

### Të lexuarit

Nxënëset dhe nxënësit kanë gëzim në të lexuar. Ata përjetojnë që të lexuarit mund të jetë zbavitës dhe pasurues.

Literatura është një mjet shprehjeje në çdo kulturë. Nxënëset dhe nxënësit do të duhej që të njohin lloje të ndryshme tekstesh në mënyrë ekzemplare. Ata e dinë se si dhe ku mund të gjejnë libra në *gjuhën e tyre amtare*.

Ata njohin media të ndryshme dhe lloje të ndryshme tekstesh.

Ata janë të aftë që prej teksteve të nxjerrin informacione me qëllime të caktuara, kurse atë që nuk e kuptojnë të pyesin ose të kërkojnë më tutje.

### Të folurit

Nxënëset dhe nxënësit janë në gjendje që të formulojnë gjendje faktike, të shpehin mendimet dhe ndjenjat e tyre. Ata janë gjithashtu të aftë që thënie të tjerëve t'i kuptojnë dhe të shtrojnë pyetje.

Ata mund të lexojnë tekste, t'i formojnë ato dhe të referojnë në mënyrë të lirë.

### Të shkruarit

Nxënëset dhe nxënësit kanë gëzim në të shkruar.

Ata janë në gjendje që t'i formulojnë mendimet e veta, gjendjet faktike të vërteta dhe fiktive. Ata mund të nëse është e nevojshme edhe me ndihmën e mjeteve mësimore dhe të fjalorëve - që të shkruajnë tekste në mënyrë të saktë në aspektin ortografik dhe gramatikor.

Ata e përjetojnë se edhe në *gjuhën e tyre amtare* kanë raste shumë të ndryshme për tu shprehur me shkrim, në një mënyrë të larmishme.

## Vështrime gjuhësore

Krahasimet gjuhësore sipas cikleve ua mundësojnë nxënësve dhe nxënësve

që të jenë të vëmendshëm mbi veçoritë dhe gjërat e përbashkëta në përdorimin gjuhësor, sa i përket *gjuhës së tyre amtare* dhe gjermanishtes. Shumëgjuhësia do të duhej të përjetohej si një pasuri.

Ata e përjetojnë se gjuha është e larmishme, e gjallë dhe në ndryshim, dhe se ajo mund të përdoret sipas situatës. Ata e njohin që pasuria e leksikut të tyre dhe mënyrës se si ata shprehen qëndron në lidhje direkte me gëzimin që kanë ata për *gjuhën e tyre të parë*.

Ata e përjetojnë *gjuhën e origjinës* së tyre në disa lëndë edhe si *gjuhë lëndore*.

Gjatë të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të të shprehurit, nxënëset dhe nxënësit kanë fituar njohuri bazë gramatikore dhe kanë mësuar që ato t'i përdorin.

Njohuritë gramatikore nuk do të mësohen si qëllim më vete, por ato kanë një funksion shërbyes direkt dhe do të duhej të përkrahin përvetësimin e gjuhës. Përmes pyetjeve të sërishme dhe kërkimeve me qëllime të caktuara ata e kuptojnë se njohuritë e tyre i zgjerojnë përmes gjuhës.

Nxënëset dhe nxënësit do të duhej që të udhëheqen në mënyrë suksesive nga gjuha e tyre "gojore" e origjinës drejt *gjuhës standarde*.

## Shkrimi dhe modelimi grafik

Nxënëset dhe nxënësit e njohin shkrimin e *gjuhës së tyre amtare* për aq sa është e nevojshme ai për komunikim në gjuhën e shkruar.

Mjetet e shkrimit dhe energjia modeluese qëndrojnë në një marrëdhënie të përshtatshme me qëllimin e shkrimit.

## 6.2 Njeriu dhe mjedisi

### Individi dhe shoqëria

Në kontakt me njerëzit, nxënëset dhe nxënësit mësojnë të dëgjojnë, t'i përceptojnë ndjenjat dhe të futen në hallet e bashkëbiseduesit. Ata sërish e rishqyrtojnë pasqyrimin të cilin e kanë bërë për vete dhe për të tjerët.

Ata konfrontohen në mënyrë rrënjësore me *kulturën e origjinës* dhe zhvillojnë çiltërsinë e tyre për kulturën e *vendit mikpritës*. Ata pikasin se për ta gjetur identitetin e tyre mund t'i përdorin elementet e të dy kulturave.

Përmes konfrontimit të vetëdijshëm me shumë përvoja nga familja, nga shokët/shoqet, nga shkolla, nga *vendi i origjinës*, nga bashkatdhetarët dhe institucionet religjioze, ata do të fitojnë një vështrim në larminë e lidhjeve të ndërsjella sociale dhe ndikimeve të ndërsjella. Ata pikasin se individi është pjesë e shoqërisë prej së cilës ndikohet dhe në të cilën ai ndikon.

Religjioni - i kuptuar si kulturë religjioni dhe jo si një mësim religjioni konfesional - është pjesë e historisë së vendit të origjinës dhe të kulturës. Krahasimet me religjionet e tjera - para së gjithash nëse janë të

pranishme disa në *vendin e origjinës*- ose me ato të *vendit mikpritës* ndihmojnë për të arritur një mirëkuptim më të mirë për religjionet e ndryshme.

Nxënëset dhe nxënësit krijojnë përvojën se bashkëjetesa njerëzore dhe përkujdesja e dyanshme, si dhe kujdesi për rregullat janë të domosdoshme. Por, ata janë megjithatë të vetëdijshëm se këso rregullash vijnë nga konceptimi i vlerave dhe i normave, të cilat janë të ndryshueshme.

Ata pikasin se përgjigjet në shumë pyetje themeltare kanë karakter besimi dhe me këtë mund të vlerësohen vetëm sipas konceptimit personal të vlerave. Ata njohin kriteret e vlerave dhe traditat e *kulturës së origjinës* dhe konfrontohen me to.

Ata qëndrojnë në *kulturën e tyre të origjinës* dhe njëkohësisht janë të hapur për kulturën zvicerane. Ata mësojnë që ndjenjat e përkatësisë së tyre në të dy hapësirat jetësore t'i integrojnë në personalitetin e tyre. Të përjetuarit e vetëdijshëm të të dy fushave të përvojave menjëherë konfliktet e lojalitetit.

Ata mund t'i perceptojnë detyrimet sociale. Ata kërkojnë që konfliktet t'i zgjidhin në mënyrë të padhunshme, përmes bisedës dhe respektit të dyanshëm. Në përpjekjet për ta bashkëformuar zhvillimin personal, ata mësojnë që hapësirat e lira t'i shfrytëzojnë me përgjegjësi. Gjatë fazës kalimtare për tu bërë të rritur ata mësojnë që t'i emërtojnë ndjenjat e veta dhe të huaja, ta formulojnë frikën dhe t'i bisedojnë përmes veprimeve orientuese sfidat e reja.

Njohuritë elementare orientuese mbi aspektet mendore, shpirtërore dhe trupore të paraardhësve të njeriut si dhe një leksiku përkatës në *gjuhën e origjinës* ju ndihmon atyre për një mirëkuptim të thelluar për veten dhe të tjerët, dhe kjo ua mundëson atyre që të orientohen në jetën e vet. Ata kanë njohuri mbi nocione të domosdoshme, të cilat ua mundësojnë atyre për të folur mbi perceptimet personale, mbi nevojat dhe kërkesat e tyre.

Ata veprojnë me ndjenjë përgjegjësie kundrejt shëndetit të vet fizik dhe psikik si dhe të njerëzve të tjerë.

## **Natyra dhe teknika**

Nxënëset dhe nxënësit fitojnë në vetëdijen e tyre për bashkëveprimet mes natyrës, teknikës dhe njeriut, në kuptim të rregullave të brendshme që janë me vlefshmëri universale.

Ata i kuptojnë shkallët e ndryshme të zhvillimit (teknologjik). Ata mësojnë në *gjuhën amtare* në mënyrë ekzemplare nocione nga fusha e natyrës, njeriut dhe teknikës.

## **Atdheu dhe Bota**

Nxënëset dhe nxënësit përballen me *vendin e origjinës* ose me prindërit e tyre me interesim dhe gëzim.

Përmes hulumtimit të vet dhe me ndihmën e fotografive, hartave dhe të mediave të tjera ata fitojnë një pamje diferencuese për të dy vendet, duke iu falënderuar reflektimit dhe krahasimit që bëjnë me Zvicrën.

Përmbajtjet gjeografike, ekonomike dhe ekologjike i zgjerojnë njohuritë mbi *vendin e origjinës*. Këto njohuri themelore orientuese ju ndihmojnë atyre për ta vëzhguar *vendin e origjinës* në tërësinë e tij, si dhe për t'i renditur dhe peshuar informacionet nga burime të ndryshme. Kjo u ndihmon atyre për tu gjendur më mirë edhe në *vendin e origjinës*.

Ata kofrontohen me format e jetës dhe të punës në vendin e origjinës dhe i krahasojnë ato me Zvicrën.

Ata janë të informuar mbi *vendin e origjinës* së prindërve të tyre. Me pjestarët e grupeve të ndryshme nga *vendi i origjinës* dhe në Zvicër ata sjellen mundësisht në mënyrë objektive. Këtu ata përpiqen që të kenë mirëkuptim për konceptimet e vlerave dhe format e jetës. Ata i njohin paragjykimet e huaja dhe të vetat dhe mundohen që me to të merren në mënyrë konstruktive.

Ata i njohin mundësitë për të treguar lidhjen e tyre me *vendin e origjinës* së familjes së tyre, me Zvicrën, si dhe me pjesën tjetër të botës.

## **E kaluara, e tashmja, e ardhmja**

Nxënëset dhe nxënësit i njohin dhe kanë respekt për historinë dhe të mirat kulturore të *vendit të tyre të origjinës*, të kohës së tashme dhe të së kaluarës.

Në bazë të njohurive orientuese elementare në fushën historike ata mund të bëjnë një renditje të ngjarjeve, zhvillimeve dhe dëshmimeve nga historia dhe nga e sotmja e *vendit të origjinës*. Historia e emigrimit luan në këtë rast një rol të rëndësishëm.

Ata janë të vetëdijshëm se çdo paraqitje është subjektive dhe përmban vlerësime. Ata e kuptojnë se qëndrimet dhe interesat e ndryshme mund të kuptohen më mirë kur shikohen nga sfondi historik.

Ata pikasin se njerëzit përmes të ndijuarit, të menduarit dhe të vepruarit ndikojnë në zhvillimet e ndryshme. Nxënëset dhe nxënësit preokupohen me problemet globale, nacionale dhe regjionale dhe i përceptojnë ndikimet e tyre të drejtpërdrejta në ambientin e tyre jetësor.

Ata kanë një vështrim në raportet e ndërsjella mes politikës, ekonomisë dhe kulturës.

Ata i njohin mundësitë për të ndikuar vetë në zhvillimet e tashme dhe ato të ardhme. Ata i dallojnë proceset politike, mund të shpjegojnë dhe formojnë një kuptim për veprimet politike demokratike në Zvicër dhe në *vendin e origjinës*.

Ata i njohin të drejtat themelore të njeriut dhe të fëmijëve dhe orientohen sipas tyre. Ata e dinë se njerëzimi tek është në rrugë për t'i zbatuar plotësisht këto të drejta.

## **7. Vështrim mbi gjysmëtemat dhe temat-kornizë të përshtatshme<sup>7</sup>**

Temat kornizë	Cikli i ulët	Cikli i mesëm	Cikli i lartë
Unë dhe të tjerët – jetojmë bashkërisht	Të njihemi; Shkolla; Rregullat; Shoqëria; Konfliktet; Vajzat / Djemtë	Grupet e ndryshme; rregullat e ndryshme; Kultura e origjinës- dhe kulturat e tjera; Konfliktet; Toleranca	Politika; Shoqëria; Pakicat; Integrimi; Ndryshimet aktuale, Racizmi, Antiracizmi
Familja	Familja e ngushtë; Të afërmit; Vizitat	Ndarja e detyrave- dhe e punës; forma të ndryshme të familjeve	Mirëkuptimi (personal) i roleve; Vlerat personale; Etika
Loja; Koha e lirë	Luajmë bashkërisht; Vendet e lojës; Koha e lirë; Sendet e lojës: moderne – tradicionale	Oferta të ndryshme për kohën e lirë; Sporti; Lojërat kompjuterike; Grupet e të rinjve	Organizimi i kohës së lirë; Vendtakimet për të rinjtë; Kulturat e të rinjve (Muzika, Gjuha); Peergroup; Komunikimi me mediat
Banimi; Kuarti; Qyteti	Banesa; Shtëpia; Rrethi; Rruga për në shkollë; Komunikacioni	Kuarti/Fshati; Shitoret; Mjetet e komunikacionit; Shtëpitë dhe banimi	Krahasimi i formave të banimit në Zvicër dhe në vendin e origjinës; të merren parasysh ndryshimet në kohë;
Festat; Festimet; Shprehjet; Ushqimi	Ditëlindja dhe festat e tjera të rëndësishme; Zakonet në të ushqyer	Festimi i ndryshëm i festave; Traditat religjioze; Rrobat	Të ushqyerit; Moda
Shëndeti	Trupi	Udhëheqja e shëndetshme e jetës	Varshmëria; SIDA; Seksualiteti
Gjeografi  Natyra; Ekologjia	Nocionet për orientim në hapësirë; nocionet e para të të vërejturit  Shtazët shtëpiake; Pemët; Perimet; katër elementet; Pylli	Nocionet për degëzimet në hapësirë Gjeografia postare; Nocionet e të vërejturit  Bimët dhe kafshët; Moti; Koha; Njeriu dhe natyra	Karakteristikat gjeografike të viseve të vendit të origjinës  Leksiku nga shkencat natyrore; Ekologjia
Përrallat; Tregimet; Literatura; Arti	Këngët; Rima; Përrallat; Librat me ilustrime	Tregimet, Sagat, Fabulat nga Atdheu; Biblioteka interkulturore	Shembuj nga literatura: klasike dhe moderne; Filmat; Arti dhe mediat e ndryshme; Artistët
Vendi i origjinës Historia	Kur isha i vogël...; Udhëtimi në vendin e origjinës; Pushimet	Historia e familjes, Emigrimi; Atdheu më herët dhe tash	Historia; Edukata sociale; Edukata qytetare
Puna; Profesionet	Puna e prindërve; Profesionet në shkollë	Dobitë nga puna; Profesionet e ëndërruar	Zgjedhja e profesionit në fushën tensionuese mes iintegritimit dhe kthimit. Ndryshimet e profesioneve në vendin e origjinës Aspekte të specifikave kulturore – gjinore; Papunësia

## 8. Fjalorth: Nocionet e mësimit të gjka dhe sqarimet për to

Në fjalorth do të definoohen dhe sqarohen nocionet qendrore nga fusha e gjuhës dhe nga fusha kulturore-politike, të cilat janë shumë të rëndësishme për ta kuptuar planin mësimor dhe kontribuojnë që të kuptohet më mirë situata specifike e fëmijëve të familjeve të emigruara.

### Vendi mikpritës

Është një vend, në të cilin një familje (ose babai apo nëna) ka emigruar, dhe është vendosur përkohësisht ose përgjithnjë (këtu në Zvicër).

### Dialekti

Dialekti është një gjuhë e kufizuar e një vendi apo regjioni ose një variant regjional i një gjuhe. Dialektet shfaqen rrallë në formë të shkruar. Ato mund të dallohen shumë nga gjuha letrare. Dialekti mund t'i përgjigjet gjuhës së rrethit.

### Gjuha e parë

Mësimi i gjuhës së parë parimisht është mësimi i parë dhe më i rëndësishëm i gjuhës. Ky mësim shkon dorë për dorë me zhvillimin kognitiv dhe social. Parimisht një fëmijë i moshës shkollore është në gjendje që të flas rrjedhshëm në gjuhën e tij të parë (më herët e quajtur gjuha amtare) dhe të kuptohet. Për fëmijët e familjeve të emigruara kjo gjuhë mund t'i përgjigjet gjuhës së origjinës (shiko kolonën tjetër). Gjuha e parë mbetet gjuhë e parë edhe nëse me kohën nuk është më gjuhë dominante.

### Gjuhët profesionale

Një gjuhë profesionale është një variant i gjuhës standarde, e cila është e karakterizuar nga një leksik specifik profesional.

### Gjuha/ët familjare

Bëhet fjalë për një gjuhë (ose mbase edhe për dy gjuhë), të cilat fliten përgjithësisht në tërë rrethin familjar. Ajo nuk është e thënë të jetë gjuha e parë e fëmijëve ose t'i përgjigjet gjuhës së rrethit.

### Me gjuhë të huaj

Me gjuhë të huaj janë ata fëmijë të cilët e zotërojnë gjuhën e tyre të parë, por jo ose vetëm pak gjuhën e cila flitet në përditshmërinë e rrethit, tek ne gjermanishtja zvicerane dhe gjermanishtja.

Të qenurit me gjuhë të huaj nuk është diç statike. Fëmijët me gjuhë të huaj e humbin pjesërisht për një kohë të shkurtër këtë atribut, përmes asaj që ata bëhen dygjuhësorë.

### Kultura e origjinës

Kultura e origjinës i përgjigjet kulturës së vendit të origjinës ose kulturës së vendit përkatës.

## **Vendi i origjinës**

Bëhet fjalë për një atë vend, në të cilin anëtarët e një familjeje të emigruar kanë jetuar më parë. Nuk është e thënë të jetë vendi, në të cilin kanë pasur qëndrim më së fundi.

## **Gjuha e origjinës**

Gjuha e origjinës është ajo gjuhë e cila në vendin e origjinës së të emigruarve është gjuha e rrethit dhe /ose gjuha standarde. Në këtë plan mësimor kornizë ne flasim edhe për gjuhën e gjka.

## **Gjuha letrare, gjuha standarde**

Gjuha letrare i përgjigjet gjuhës së shkruar, gjuhës oficiele, gjuhës së literaturës. Nocioni gjuhë standarde përdoret si sinonim për gjuhën letrare. Ajo i nënshtrohet gjerësisht normimit, i cili përmes mediave publike, por para së gjithash përmes sistemit arsimor përcjellet dhe kontrollohet. Zotërimi i gjuhës standarde është si qëllim kryesor i përpjekjeve didaktiko-gjuhësore në shkollë.

## **Identiteti (bikulturor)**

Identiteti është perceptimi i vetvetes. Nën një identitet bikulturor kuptohet një identitet personal dhe i tërësishëm, i cili përmban aftësinë e veprimit e komunikimit në dy kultura, si dhe në sistemin e koordinatave gjuhësore.

## **Integrimi, integroj**

Integrimi mendohet një proces, në të cilin personat dhe grupet me një sfond të ndryshëm social, kulturor dhe gjuhësor, arrijnë një pjesëmarrje të barabartë sociale dhe politike në një shoqëri dhe respektohen me sfondin e tyre të veçantë gjuhësor dhe kulturor.

## **Interferenca**

Për interferenca flitet atëherë kur elemente të gjuhës së parë barten në një gjuhë tjetër dhe atje gjenden në vend të gabuar.

## **Kompetenca interkulturore**

Kompetenca interkulturore përfshin mirëkuptimin dhe veprimin në dy kultura dhe lidhshmëritë sipas situatave të sjella, si dhe ndërrimin mes të njëjtave. Të jetosh në dy kultura mund të ta sjell shansën që ta zgjerosh këtë kompetencë të rëndësishme shoqërore.

## **Ndërmjetësimi kulturor, mësuesi i gjka- si ndërmjetësues kulturor**

Aty ku njerëzit nga sisteme referimesh të ndryshme kulturore bashkëtakohen, mund të paraqiten vështirësi në fushën e komunikimit si keqkuptimi, moskuptimi, dyshimi ,etj. Mësuesi i gjka mund të ndërmjetësoj në konflikte të tilla dhe të kontribuoj që problemet të zvogëlohen ose edhe të zgjidhen apo të mënjanohen.

## **Disa gjuhë, mësimi gjuhësor bilingual**

Shumë fëmijë mësojnë së pari jo vetëm një gjuhë, por njëkohësisht, ose pas një kohe të shkurtër dy ose më shumë gjuhë. Në këtë rast një fëmijë ka disa gjuhë të para; atëherë flitet për bilingualizmin primar.

## **Përvojat emigruese**

Këto janë përvoja specifike, të cilat i bëjnë njerëzit të cilët e kanë përjetuar emigrimin, d.m.th., ata largohen nga sistemi i tyre i njohur shoqëror, gjenden mirë në një sistem të ri dhe atje në parim jetojnë në statusin e minoritetit.

## **Gjuha amtare**

Me gjuhë amtare mendohet gjuha e parë e mësuar. Nocioni është i pasaktë, sepse ai nisët nga ajo që vetëm nëna është vendimtare për mësimin e gjuhës së parë. Plani mësimor e përdorë megjithatë këtë nocion, sepse ai thjesht ende përdoret. Pastaj ky nocion i nënshtrohet anës emocionale të gjuhës së parë. Kështu, gjuha amtare mund të theksohet si e tillë ndaj së cilës kemi një marrëdhënie të ngushtë emocionale. Nuk është ndonjë parakusht që ajo të flitet pa gabime.

## **Të emigruarit e rinj, të shpërngulurit e rinj, të mërguarit e rinj**

Këto nocione përdoren si sinonime ku të shpërngulurit e rinj mund të jenë edhe nga një vend ose pjesë tjetër e qytetit.

## **Gjuha e rrethit**

Gjuha e rrethit është gjuha e folur e cila në një rreth flitet më shumë, këtu dialekti i gjermanishtes zvicerane. Nëse gjuha e rrethit dhe e familjes nuk janë identike, atëherë gjuha e familjes i nënshtrohet një presioni të madh të gjuhës së rrethit. Para se gjithash fëmijët me kohë mund ta parapëlqejnë gjuhën e rrethit më shumë se gjuhën e familjes dhe atë ta përdorin si gjuhë të re familjare.

## **Gjuha e dytë**

Nëse një fëmijë pasi që e ka mësuar një gjuhë të parë, e mëson një gjuhë të dytë, atëherë këtë të fundit e emërtojmë si gjuhë të dytë. Kjo ndodh më së shumti tek mësimi i gjuhës në moshën shkollore ngase këtu njeriu e mëson gjuhën e tij të parë (gjuhët e tij të para) si fëmijë. Mësimi i gjuhës së dytë nuk i shërben më përgjithësisht mësimin të nocioneve. Ai mund të ndërtohet më tutje në nocione të cilat janë formuar në gjuhën e parë. Në raste të veçanta, është vështirë të dallohet tek familjet dy-apo shumëgjuhësore se a bëhet fjalë për një gjuhë të dytë apo për një gjuhë tjetër të parë.

## **Mësimi dygjuhësor**

Në didaktikën gjuhësore ka dallime mes mësimin dygjuhësor dhe atij për gjuhë të huaj. Nëse një fëmijë e mëson gjuhën e tij të dytë në vendin në të cilin kjo gjuhë flitet si gjuhë shkollore dhe e komunikimit, atëherë bëhet fjalë për mësimin e një gjuhe të dytë. Fëmijët e huaj pra mësojnë gjermanishten si gjuhë të dytë në Zvicrën gjermane.

## Dygjuhësia

Dygjuhësia është aftësia individuale dhe praktika që dy ose më shumë gjuhë të përdoren duke i ndërruar. (Aequilingualismus). Ky është një formulim i qëllimit dhe jo një gjendje aktuale. Për këtë arsye kompetencat në të dy gjuhët nuk duhet të mbulohen domosdoshmërisht. Nëse është një dallim i madh mes kompetencave në njërën gjuhë dhe në tjetrën gjuhë, atëherë flitet për *bilingualizmin* dominant.

Shkalla e dygjuhësisë varet, ndër të tjera, edhe nga lehtësia që me kompetencat që mungojnë në një gjuhë të mund të plotësohen me kompetencat e gjuhës tjetër.

Nëse të dy gjuhët zotërohen keq, atëherë flitet për gjysmëgjuhësinë (Semilingualismus).

Përkthyer nga: Nexhat Maloku

Bartësi: Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë " Naim Frashëri"

Cyrih, Qershor 2004